



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Nr. 01-111/01-9173
Më: 20.02.2026

Komuna e Lipjanit bazuar në nenin 16 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 dhe në mbështetje të neneve të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e datës 4 qershor 2008, dhe neneve 40 e 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021 shpall konkurs për praktikantë me pagesë:

KONKURS PËR PRAKTIKANTË

- **Titulli i vendit të Punës: Praktikant/e – 44 (dyzet e katër pozita) nga drejtimet e cekura:**
 1. Fakulteti: Arkitekt, Inxhinier i Ndërtimtarisë, Hidros, Inxhinier i Elektros, Komunikacionit.
 2. Fakulteti: Juridik, Administratë Publike, Ekonomist, Psikologji, Sociologji, Edukatore, Gjeodezi, Infermieri/e dhe Punë Sociale.
- **Orari i plotë 40 orë në javë**
- **Kohëzgjatja e praktikës: 6 (gjashtë) muaj.**
- **Pagesa: 300 € (treqind euro) në muaj.**
- **Dokumentet e kërkuara:**
- **Diploma Universitare,**
- **Drejtimet: Arkitekt, Inxhinier i Ndërtimtarisë, Hidros, Inxhinier i Elektros, Komunikacionit** dokumentet e kërkuara Diploma Universitare (për ata që nuk kanë përfunduar studimet - vërtetimin që dëshmon se janë duke i vijuar studimet universitare në drejtimet e fakultetit sipas pikës 1).
- **Dokumenti i identifikimit**

Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkuara:

- Të ketë njohuri të përgjithshme
- Të ketë aftësi komunikimi;
- Të ketë aftësi në organizimin e punës dhe në kryerjen e detyrave të punës.
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access, Internetit).

Praktika profesionale synon përvetësimin efektiv të njohurive teknike, praktike dhe etike të profesionit. Aplikantët e suksesshëm do të sistemohen në Administratën e Komunës së Lipjanit dhe do të angazhohen të kryejnë detyrat e përgjithshme nëpër Drejtorate dhe sektorë për kryerjen e punëve profesionale. Pagesa e praktikantëve do të bëhet nga kategoria ekonomike-subvencionet e planifikuara për vitin 2026.

Data e mbylljes së konkursit 8 ditë nga shpallja në mjetet e informimit publik.

Formularët e kërkesave janë në dispozicionin tuaj dhe mund t'i merrni në Qendrën për Shërbime me Qytetar në Komunë në sportelin Nr. 3 dhe po aty bëhet dorëzimi i aplikacioneve.

Kërkesat e arritura pas afatit nuk do të shqyrtohen. Kërkesat e pakompletuara refuzohen.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranura vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

"Të drejte aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi për të vepruar, kanë përgatitjen e nevojshme shkollore dhe aftësi fizike që kërkohej për pozitën përkatëse"

IMRI AHMETI
KRYETAR I KOMUNES

